

Datës-lizazne

Nr. X-1145 Data 20.11.2019
Dr. Datum

08110-08110



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obiliq

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në neniet 6 dhe 19 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave ,Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktivitet Jashtëshkollorë, Nr. –I-149, të datës 30.08.2019, dhe kërkesën me nr.-X -1144 të datës 20.11.2019 , Drejtoria e Arsimit më 20.11.2019 shpall:

KONKURS

Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës të komunës së Obiliqit të këtyre kategorive:

- 1.Për nxënës nëse distanca e udhëtimit shtëpi –shkollë është së paku 3.5 kilometra
- 2.Për nxënës me nevoja të veçanta
3. Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, në aspektin e gjendjes ekonomiko- financiare (në qoftë se në relacionet e udhëtimit të këtyre nxënësve është i organizuar udhëtimi publik apo privat).
- 4.Për nxënës të Obiliqit në shkollat e mesme të larta në Prishtinë , në drejtimet që nuk janë në shkollat e Obiliqit

Dokumentet e nevojshme për të gjitha kategoritë :

- Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i rregullt dhe për distancën shtëpi-shkollë
- Letërnjoftimi(në mungesë të letërnjoftimit të sjell certifikatën e lindjes),
- Konfirmimin bankar.
- Për rastet nxënës me nevoja të veçanta, të sjellin edhe diagnozën e mjekut
- Për rastet sociale, të sjellin edhe vërtetimin nga Qendra për Punë Sociale në Obiliq.

Komisioni për ndarjen e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit e ruan të drejtën, të verifikojë gjendjen faktike të kriterëve të kërkuara sipas konkursit për kandidatët që kanë aplikuar për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit .

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimit të KK-së dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njejtën Zyrë. Afati i konkurrimit është deri më 22.11.2019 .

Drejtori :Agim Spahiu

